



JEMI DEMOKRATË



SISTEMI MË I MIRË I QEVERISJES QUHET...

PETRIT (14), ENDRIT (15), ARBEN (16), ARBENITA (15), ALKETA (14), GENTIANA (15)




A e dini se çka është demokracia? Cili është roli ynë në demokraci? Pse demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes? Këto informata mësoni në këtë artikull të shkruar me shumë dashuri për ju

Të jetosh në demokraci do të thotë të jesh i lirë dhe të kesh të drejtën të vendosësh për të ardhmen tënde. A keni menduar ndonjëherë se pse demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes? Demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes, sepse secili qytetar, i cili jeton brenda një shteti demokratik, ka të drejtën e shprehjes së lirë, ka të drejtën të marrë pjesë në procesin zgjedhor dhe ka të drejtën të trajtohet në mënyrë të barabartë, si gjithë të tjerët.

Kjo formë e qeverisjes për herë të parë është shfaqur në Athinë të Greqisë, në vitin 507 para erës së re. Në atë kohë, nuk kishte demokraci të plotë, për arsye se nuk kishte të drejta të barabarta për të gjithë. Vetëm burrat e pasur kishin të drejtë vote, ndërsa të varfërit

dhe gratë nuk e gëzonin këtë të drejtë. Por, gjërat ndryshuan me kohën, sepse duke e parë se barazia është një prej elementeve kyçe të demokracisë, u vendos që të gjithë të trajtohen të barabartë pa marrë parasysh nivelin e edukimit, racën, fenë, gjininë, etj.

Për këtë arsye në një shtet demokratik është e rëndësishme pjesëmarrja aktive e secilit qytetar në mënyrë që të ndërtohet edhe më shumë demokracia. Me këtë nënkuptojmë se secili qytetar mund ta jap kontributin e tij në forma të ndryshme. Për shembull, edhe ne nxënësit edhe pse nuk e kemi të drejtën e votës deri në moshën 18 vjeçare, mund t'i zbatojmë me përpikmëri elementet përbërëse të demokracisë si: lirinë, paqen, tolerancën, barazinë, etj. Prandaj, ju ftojmë edhe juve qytetarë të dashur që t'i respektoni sa më shumë këto elemente, sepse ne jemi ata që e ndërtojmë demokracinë dhe ne jemi ata që mund të bëjmë ndryshime të shumta për të ardhmen e shtetit tonë.



Elementet përbërëse të demokracisë



Ne gjithmonë do të mbështesim sistemin demokratik

RËNDËSIA E ZGJEDHJEVE

RINESA (14), MERGIM (14), EDON (15), LIRIDONA (15), ARLIND (15), VALMIR (15)




Për të kuptuar pse janë të rëndësishme zgjedhjet dhe se kush ka të drejtë të votojë, ju lutem lexojeni artikullin tonë

Ne si fëmijë kemi dëshira të shumta dhe po ashtu nevoja të shumta. Dëshirat tona ndonjëherë plotësohen e ndonjëherë jo. Por, pse ndodh kjo?

Gjendja ekonomike në Kosovë nuk është edhe aq e zhvilluar, por prindërit tanë janë ata të cilët na qëndrojnë çdo herë pranë dhe përpiqen që me mundësitë e tyre të na i përmbushin nevojat tona. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ata nuk i marrin parasysh mendimet tona për ndonjë vendim të rëndësishëm, të cilin e marrim në familje. Për shembull, kur planifikojmë të bëjmë ndonjë vizitë në ndonjë vend të Kosovës, secili anëtar i familjes jep sugjerimet e tij dhe në fund votojmë se cilin vend do ta vizitojmë.

Zgjedhje të tilla ne bëjmë gjatë gjithë kohës, si në shtëpi kur dëshirojmë ta shikojmë ndonjë emision së bashku me familjen apo të përgatisim diçka për drekë, etj. Përveç këtyre zgjedhjeve të përditshme, ekzistojnë edhe zgjedhje të tjera, prej të cilave varet e ardhmja jonë. E këto janë zgjedhjet lokale, ku qytetarët e një komune përkatëse votojnë për kryetarin e tyre, si dhe zgjedhjet qendrore, ku qytetarët e gjithë Kosovës votojnë për kandidatët për deputetë. Zgjedhjet që ne i bëjmë janë shumë të rëndësishme, sepse personat që zgjedhim përfaqësojnë interesat, nevojat dhe kërkesat tona.

E rëndësishme të dijmë është se të drejtë vote kemi të gjithë, por pasi që për ta zgjedhur një kryetar komune apo një deputet të Kuvendit të Kosovës duhet të jemi shumë të vendosur për zgjedhjen tonë, ligji e kërkon që një individ t'i mbushë 18 vjet që ta fitoj të drejtën për të votuar, sepse atëherë jemi të vetëdijshëm dhe nuk veprojmë pa menduar mirë.



Ta zgjedhim të duhurin për një demokraci të mirëfilltë



E ardhmja e Kosovës në duart tona

BALANCIMI I FUQIVE

ALBANIT (14), ALBIN (15), ARBEN (16), BESMIR (15), FORTESA (15), HYSNIE (15)




Ndarja e pushtetit siguron balancimin në mes institucioneve

Ky artikull flet më shumë për ndarjen e pushtetit, për anët pozitive të kësaj ndarje, si dhe arsyen se pse ne si qytetarë të një shteti jo shumë të madh iu rekomandojmë të gjitha vendeve të tjera, të cilat nuk kanë ndarje të pushtetit, që sa më shpejtë ta praktikojnë atë. Shtetet të cilat kanë udhëheqje diktatoriale apo edhe ato të cilat kanë udhëheqje nga monarku, udhëhiqen nga një ose disa individë të caktuar. Kjo pa dyshim që nuk është në të mirë të popullit, sepse i gjithë ai popull do të duhej t'i bindej vetëm atyre personave.

Shtetet demokratike e kanë pushtetin e ndarë dhe në këtë mënyrë secili pushtet ka ndikimin e vet. Ndërsa, në shtetet të cilat nuk e kanë pushtetin e ndarë, institucionet udhëhiqen prej personave të njëjtë.

Ne brenda grupit të vogël e bëmë një simulim të vendeve që kanë ndarje të pushtetit, si dhe atyre që nuk e praktikojnë këtë ndarje. Besmiri luajti rolin e diktatorit dhe ne nuk patëm as mundësinë më të vogël për të pyetur apo kundërshtuar, kjo sepse e gjithë fuqia ishte tek shoku ynë. Por, pastaj të gjithë fuqinë e shokut Besimiri e ndamë, dhe secili prej nesh tani ishte përgjegjës për punën e tij. Në këtë formë e ndamë fuqinë e Besmiri, në mënyrë që kjo fuqi të mos keqpërdorej. Kjo d.m.th. se popullata e një vendi diktatorial nuk i gëzon të drejtat si populli që udhëhiqet në mënyrë demokratike. Ndërkaq, shtetet demokratike e ndajnë pushtetin në tri degë, të cilat janë: Pushteti Legjislativ, Ekzekutiv dhe ai Gjyqësor. Te Pushteti Legjislativ

hyn Kuvendi. Kuvendi ka tri funksione, të cilat janë: propozimi dhe miratimi apo mos miratimi i ligjeve, përfaqësimi i popullit si dhe ushtrimi i funksionit të kontrollit ndaj Qeverisë. Pushteti Ekzekutiv ushtrohet nga Qeveria. Qeveria propozon ligje dhe i zbaton ato. Kurse, Pushteti Gjyqësor ushtrohet nga gjykata. Ne mendojmë që të gjithë ato shtete, institucionet e të cilave funksionojnë në mënyrë të ndarë nga njëra-tjetra funksionojnë më mirë. Por, po ashtu edhe qytetarët e atyre shteteve janë të kënaqur me atë formë të qeverisjes.



Edhe këtu kemi një ndarje të vogël të fuqive

QYTETARIA AKTIVE DHE NDIKIMI I SAJ

KASTRIOT (15), FLORENT (15), KOSOVARE (14), ENDRIT (15), ALBINA (14), GENTA (14)

Ne si nxënës të klasës së IX-të, kemi vendosur të bëjmë një përmbledhje të gjërave që ne mund t'i bëjmë dhe të cilat mund të jenë me ndikim në shtetin tonë

Në krijimin e një shteti të zhvilluar ka ndikim të madh vetë populli, i cili mund të bëjë ndryshime të mëdha. Si qytetar aktiv konsiderohet secili person që merr pjesë në zhvillimin e një shteti.

Grupi ynë mendon se sot në vendin tonë duhet që qytetarët të vetëdijësohen për disa gjëra, si p.sh.: ruajtjen e ambientit, pjesëmarrjen aktive në organizata të ndryshme, pjesëmarrjen në tubime publike, etj. Këto gjëra mund të arrihen nëse të gjithë së bashku kontribuojmë në përmirësimin e vendit apo bëjmë organizime të ndryshme për vetëdijësimin e popullit.

Pra, në demokraci fuqia është e popullit dhe vendimmarrja i takon popullit. Edhe pse në demokraci ka shumë llojshmëri të interesave, bashkëpunimi gjithmonë është i nevojshëm. Çfarë duhet të bëjë populli në demokraci? Duhet të jetë i përgjegjshëm për veprimet e tij.



Grupi „Aktivistët“




Bashkëpunimi me të tjerët



Endriti duke shpjeguar rëndësinë e votës në demokraci



Qytetarët aktiv mendojnë dhe punojnë për zhvillimin e vendit, p.sh. pjesëmarrja në një organizatë, e cila merret me vetëdijësimin e të rinjëve për dëmet që mund të shkaktojnë substancat e ndryshme narkotike



Demokracia është gjithëpërfshirje e popullit në vendimmarrje. Disa elemente të demokracisë janë: liria e shprehjes, e drejta e votës, toleranca, solidariteti, bashkëpunimi, respekti, etj



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Akrashticë“
Klasa: IX
Vendi: Vushtrri